



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/26
Datë: 23.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafit 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafi 3 dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet Nr. 04/L-111 dhe 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 paragrafin 2.4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Korporata Elektroenergjetike e Kosovës" Sh. A.
2. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i ndërmarrjes nga pika 1 me këtë përbërje:
 - 2.1. Rrezarta Pllana, kryesuese dhe drejtore;
 - 2.2. Merita Kasapolli, drejtore;
 - 2.3. Arbnor Pula, drejtor, dhe
 - 2.4. Bezat Halilaj, drejtor.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Për arsyet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "KEK" Sh. A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Investicija
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

DATË/E:	23.4.2020
PËR/ZA/TO:	Qeverinë e Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	Rozeta HAJDARI – Ministre në detyrë, MEPTINIS
TEMA/ SUBJEKAT/ SUBJECT:	Memorandum shpjegues për propozim-vendimin për shkakimin e bordit të drejtorëve dhe emërimin e bordit të përkohshëm të drejtorëve të ndërmarrjes publike qendrore “Korporata Energjetike e Kosovës” Sh.A. [korrigjuar]

I nderuar Kryeministër Kurti,
i nderuar zëvendëskryeministër Abazi,
të nderuar ministra:

Si ministre përgjegjëse, i propozoj Qeverisë të shkarkojë bordin e tanishëm të ndërmarrjes “Korporata Energjetike e Kosovës” Sh.A. dhe të emërojë menjëherë një bord të përkohshëm. Këtë propozim e jap duke u mbështetur në Kushtetutë dhe në Ligjin për ndërmarrjet publike.¹ Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., shkurt “KEK”,² është ndërmarrje publike qendrore, në pronësi të Republikës së Kosovës.³

1. Shkarkimi i bordit të drejtorëve

Sipas ligjit, drejtorët e ndërmarrjes duhet të veprojnë në përputhje me detyrat fiduciare.⁴ Në të drejtën e qeverisjes së ndërmarrjeve, termi *detyrë fiduciare* përkufizohet si detyrë për të vepruar me ndershmërinë e besnikërinë më të lartë ndaj ndërmarrjes dhe në interesin më të mirë të saj.⁵ Në ushtrimin e të drejtave të aksionarit, Qeveria duhet t’i shkarkojë drejtorët menjëherë nëse ka “arsye për të besuar” se kanë shkelur detyrat fiduciare.⁶

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 119.9; Ligji 03/L-087 për ndërmarrjet publike (LNP), ndryshuar me ligjet 04/L-111, 05/L-009 dhe 06/L-021, neni 5.1.

2 Në të dhënat e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, ndërmarrja është regjistruar me emrat në tri gjuhë: Kosovo Energy Corporation J.S.C. – Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a. – Energetska Korporacija Kosova D.D.

3 LNP, neni 5.1 dhe lista 1, pika 1.

4 LNP, nenet 19 dhe 23.

5 Termi është huazuar nga anglishtja. Shih zërin *fiduciary duty* në fjalorin juridik *Black’s Law Dictionary*, 9th ed., f. 581.

6 LNP, neni 19.3.

Saktësisht, neni 19.3 i Ligjit për ndërmarrjet publike thotë:

Nëse Aksionari(ët) kanë arsye për të besuar se ka mundësi që një drejtor të ketë bërë shkeljen e detyrave fiduciare, ata menjëherë do ta shkarkojnë dhe zëvendësojnë drejtorin ose drejtorët të cilët me arsye besohet se kanë bërë shkeljen e detyrave të tyre fiduciare, edhe në mungesë të provave të qarta, pavarësisht nga rreziku që mund të paraqesë për NP-në ngritja e një padie nga ana e drejtorit/ëve të shkarkuar.

Qeveria ka një varg arsyesh për të shkarkuar drejtorët e KEK-ut: (1) shpenzimet e paplanifikuara dhe të pamatura në një kontratë me vlerë mbi 1 milion euro; (2) dhënia e bonuseve për drejtorët në kundërshtim me vendimin e Ministrit; (3) punësimet e parregullta, nepotizmi, diskriminimi e shkelje të tjera në punësim; dhe (4) keqmenaxhimi i pronës dhe shkeljet e tjera lidhur me pasuritë e ndërmarrjes.

Shpenzime të paplanifikuara dhe të pamatura

Më 11 dhjetor 2019, KEK-u ka lidhur kontratën me titull “Skanimi, arkivimi dhe in-korporimi i proceseve digitale[sic] në burime njerëzore dhe pronë”. Përfitues i kontratës është një konsorcium i dy kompanive private, “Art House” sh.p.k. dhe “Docman” sh.p.k.⁷ Vlera e kontratës është mbi 1 milion euro (792.600,56 euro bazë dhe 230.158,03 euro për shërbime opsionale), kurse kohëzgjatja 6 muaj.⁸ Konsorciumi i kontraktuar parashihet të shfrytëzojë 2–3 skanerë për të digjitalizuar dokumente të vjetra të KEK-ut.

Kontrata nuk ka qenë e paraparë në planin e biznesit.⁹ Bordi ka miratuar prokurimin në vlerë prej rreth 800 mijë eurosh, sipas një kërkesë të zyrtarëve që thirren në rekomandime të auditorëve (të brendshëm e të jashtëm).¹⁰ Por auditorët nuk kanë rekomanduar digjitalizimin e dokumenteve; ata thjesht kanë rekomanduar përditësimin e regjistrit të pronave dhe plotësimin e dosjeve të punëtorëve me dokumentet që mungojnë.¹¹ Bordi ka mundur të kërkojë shpjegime shtesë prej auditorëve, por nuk e ka bërë këtë. Thënë shkurt, bordi ka shtrembëruar rekomandimet e auditorëve për të mundësuar një kontratë dukshëm të pavolitshme. Me këtë kontratë, KEK-u i paguan konsorciumit plot 18 centë pa TVSh (ose 21 centë me TVSh) për një faqe të skanuar.¹²

Kontrata tejkalon edhe vlerën e miratuar nga bordi. Qeveria nuk ka dëshmi se bordi u ka kërkuar llogari zyrtarë për këtë tejkallim.

7 Provë: Kontratë, nr. prokurimit KEKO-19-322-211, nr. prot. 11629. Nga ecuria e prokurimit është shkualifikuar pa shkas bindës një nga ofertuesit. Dy ofertues, përfshi një nga kompanitë përfituese, kanë të njëjtin pronar. Provë: Raporti i vlerësimit të tenderëve, nr. prok. KEK-19-6876-2-1-1.

8 Kontrata, nenet 2.1 dhe 6.4.

9 Shih LNP, neni 30.1(c).

10 Provë: Vendim i Bordit të Drejtorëve të KEK-ut, nr. 4829, 21.6.2019; Kërkesa e drejtorit të burimeve njerëzore dhe drejtorit të zyrës ligjore drejtuar Bordit të Drejtorëve, pa datë.

11 Provë: Raport i auditimit të brendshëm, rasti 2018-AO-019, fq. 7, 9; Raport i auditimit të pavarur, për vitin 2017, fq. 7, 12.

12 Kontrata, fq. 15.

Bonuset në kundërshtim me vendimin e Ministrit

Më 18 dhjetor 2017, Ministri përgjegjës ka nxjerrë edhe vendim për “pezullimin e vendimeve për kompensimin për stimulimin e efektshmërisë së anëtarëve të Bordëve të Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore”.¹³ Vendimin e ka përcjellë bashkë me një vërejtje për uljen e shpenzimeve të drejtorëve.¹⁴ Vendimi dhe vërejtja u janë dorëzuar të gjitha ndërmarrjeve publike qendrore.

Por bordi i KEK-ut ka shpërfillur vendimin e Ministrit. Më 15 mars 2019, drejtorët kanë miratuar deklaratën e politikës së kompensimit të zyrtarëve për 2018-tën.¹⁵ Këtë e kanë pasuar më 31 maj 2019 me aktin tjetër për miratimin e performancës për 2018.¹⁶ Me këto dy vendime, drejtorët i kanë dhënë bonus vetes në kundërshtim me vendimin e Ministrit. Për më tepër, kriteret për vlerësim e punës i kanë vetëpërcaktuar – duke cenuar çdo pandehje korrektësie – pasi kanë kryer punën. Në këto rrethana, bordi qartazi ka vepruar në kundërshtim me interesin e ndërmarrjes.

Shkeljet në punësim – Parregullsi, nepotizëm, diskriminim

Bordi ka lejuar, shkaktuar ose shpërfillur një varg shkeljesh në punësim:

- Listat e të punësuarve në ndërmarrje dëftojnë për parregullsi dhe nepotizëm në procedura të rekrutimit. Anëtarët e bordit kanë arritur të punësojnë të afërmit e tyre në pozita të rëndësishme në menaxhmentin e KEK-ut.
- Për të mundësuar punësime të reja, ndërmarrja ka dyfishuar pozitat dhe njësitë administrative pa arsye e pa ecuri të ligjshme. Janë emëruar pa konkurs zyrtarë në pozitat drejtor i prokurimit, drejtor i zyrës ligjore, menaxher i zyrës ligjore, drejtor operativ, drejtor i qymyrit, udhëheqës i mirëmbajtjes mekanike në prodhimin e qymyrit, pozita menaxheriale në auditim, pozita në zyrën e tarifave dhe rregullativës, si dhe pozita të tjera.
- Emërimet e gradimet shpesh kanë qenë të kundërligjshme. Për shembull, është emëruar zyrtari i auditimit të brendshëm pa qenë fare kontabilist i certifikuar, siç kërkohet me ligj.¹⁷
- KEK-u ka punësuar kundërligjshëm persona mbi moshën 65-vjeçare të pensionimit dhe i ka mbajtur në punë për vite të tëra. Rrjedhimisht, ka shkaktuar dëm që kalon vlerën 270 mijë euro. Bordi nuk ka ndërmarrë veprime konform ligjit për të trajtuar këtë çështje.
- Struktura e pagave është përpiluar sipas personave, jo pozitave. Ka punonjës që paguhen dyfish sa eprori.

13 Provë: Vendim i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, nr.prot. 01/2599, 18.12.2017.

14 Provë: Vërejtje e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, nr.prot. 01/2601, 18.12.2017.

15 Provë: Vendim për miratimin e Deklaratës për Politikën e kompensimit për Zyrtarët e KEK-ut për vitin 2018, 15.3.2019, nr.prot. 3873, 11.6.2019.

16 Provë: Vendim për Miratimin e Performancës së Zyrtarëve të KEK-ut për vitin 2018, 31.5.2019, nr.prot. 3872, 11.6.2019.

17 LNP, neni 21.4 (ndryshuar).

- Ndërmarrja nuk u ka paguar punonjësve të vet pagat jubilarë që u takojnë, duke shkaktuar konteste të kushtueshme në gjykata. Por në prag të zgjedhjeve, ndërmarrja u ka dhënë pagë jubilarë punonjësve që nuk kanë pasur këtë të drejtë, dhe kështu ka shkaktuar padi për diskriminim dhe shpenzime shtesë të procedurave gjyqësore.

Keqmenaxhimi i pronës dhe shkelje të tjera

Vonesat në shpronësime po i kushtojnë shtrenjtë ndërmarrjes. Shkaku i mosveprimit dhe mosbashkëpunimit me komunën, ndërmarrja shpronëson ngastra pasi ato të jenë mbushur me ndërtesa spekulative, që s'kanë qëllim tjetër pos të përfitojnë nga kompensimi për shpronësim. Kostoja e shpronësimit në dy projekte të fundit, për sipërfaqe prej rreth 170 hektarësh, pritet të tejkalojë shumë 50 milionë euro.

KEK-u gjithashtu përballlet me rreth 20 milionë euro *kërkesa ligjore*, si pasojë e keqmenaxhimit. Një pjesë e këtyre kërkesave rrezikojnë arbitrazhin, që mund të përcillet me kosto dhe ndëshkime shtesë. Në një tjetër rast, ndërmarrja nuk ka filluar me kohë dhe nuk ka vazhduar arbitrazhin për borxhin në lartësi 4,5 milionë euro që një operator privat i ka KEK-ut nga viti 2013.

Sa i përket *menaxhimit të financave*, ndërmarrja i është detyruar rreth 11 milionë euro ndëshkime Administratës Tatimore të Kosovës. 6 milionë dyshohet se janë ndëshkime e gjoba vetëm për shkak të moskomunikimit dhe shpërfilljes së rasteve prej përfaqësuesve të KEK-ut. Ndërmarrja ka blerë pa nevojë mbi 20 vetura, ka paguar për shërbime të kontraktuara pa procedura ligjore, dhe ka lidhur kontrata për shitblerje të energjisë me operatorë që dyshohen të jenë rremë. Në fund, u janë dhënë bonuse menaxhmentit dhe auditorëve, si nxitje për të mos audituar menaxhmentin.

Në prill 2020, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur *aktakuzë* ndaj një anëtari të bordit aktual dhe disa zyrtarëve të lartë të KEK-ut për veprën penale keqpërdorim i detyrës zyrtare në lidhje me pronën e ndërmarrjes. Dëmi i shkaktuar sipas aktakuzës është rreth 12 milionë euro.

Rrjedhimisht, Qeveria ka arsye të besojë se bordi i drejtorëve ka shkelur detyrat fiduciare, duke lejuar shpenzime të panevojshme që haptazi dëmtojnë ndërmarrjen. Andaj bordi duhet të shkarkohet.

2. Emërimi i bordit të përkohshëm

Baza ligjore për emërimin

Neni 43 i Ligjit për ndërmarrjet publike, i ndryshuar dhe plotësuar, parasheh emërimin e një bordi të përkohshëm si vijon:

43.1 Qeveria është e autorizuar që ta emërojë një Bord të Përkohshëm të Drejtorëve ("Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve") për secilën NP për të shërbyer në cilësinë e Bordit të Drejtorëve të NP-së për një periudhë gjashtë-

mujore, duke filluar me miratimin e Vendimit mbi Themelimin e një Ndërmarrje Publike të re apo nga shkarkimi i bordit aktual deri në përzgjedhjen e bordit të përhershëm në përputhje me nenin 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.¹⁸

43.2 Qeveria do ta ushtrojë këtë autoritet sa më shpejtë që të jetë e mundshme pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

43.3 Secili Bord i Përkohshëm i Drejtorëve do të përbëhet nga pesë (5) anëtarë dhe duhet të përfshijë KE-në ose menaxherin e lartë të NP-së. Gjatë emërimit të drejtorëve të tjerë të një Bordi të Përkohshëm të Drejtorëve, Qeveria do të bëjë përpjekje maksimale për të siguruar që këta drejtorë t'i plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 4 të nenit 17 të këtij ligji.

43.4 Mandati i secilit Bord të Përkohshëm të Drejtorëve do të skadojë, cilado që ndodh më herët (i) mesnatën e ditës e cila rastis gjashtë (6) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji ose (ii) ditën në të cilën zgjidhet bordi i plotë i drejtorëve për NP-në përkatëse në përputhje me nenin 15 ose 16 të këtij ligji.

43.5 Çdo përpjekje për zgjatjen ose përtëritjen e mandatit të një Bordi të Përkohshëm të Drejtorëve përtej afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni është e ndaluar, e pavlefshme dhe e pa zbatueshme. Pas skadimit të mandatit të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të Përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, ky bord dhe drejtorët e tij pushojnë të kenë çfarëdo autorizimi të çfarëdo përshkrimi për të vepruar në cilësinë e Bordit të Drejtorëve të NP-së.

Deri në zgjedhjen e bordit të ri, pra, Qeveria duhet që sa më shpejt të emërojë një bord të përkohshëm, i cili shërben më së gjati 6 muaj.¹⁹ Bordi i përkohshëm ka 5 drejtorë – Qeveria emëron 4, kurse kryeshefi shërben si drejtori i pestë. Ndonëse nuk lypset konkurs, sa është e mundshme, duhet emëruar kandidatë që plotësojnë kushtet dhe cilësimet e përcaktuara në paragrafët 1 e 4 të nenit 17, për drejtorët me mandat të plotë.²⁰

Neni 19 detyron Qeverinë të shkarkojë bordin “menjëherë” kur lindin shkaqet e shkarkimit, kurse neni 43 kërkon që Qeveria të emërojë bord të përkohshëm “sa më shpejt”. Këto kërkesa natyrisht pamundësojnë konkursin, që merr muaj vetëm për të

18 Ndryshuar më 2012 me ligjin 04/L-111, neni 22.

19 LNP, neni 43.

20 LNP, neni 43.3. Paragrafi 1 i nenit 17 thotë se duhet plotësuar edhe kërkesat e paragrafëve 2 e 3. Por neni 43.3 përjashton këta dy paragrafë duke përmendur vetëm “kushtet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 4 të nenit 17 të këtij ligji”. Ky formulim pra nuk përfshin kërkesat e përcaktuara në paragrafë të tjerë. Për dallim, në dispozita të tjera hasim formulime si “kushtet e përcaktuara në paragrafët 1-3 të nenit 17” (neni 15.4), “kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe të përshtatshmërisë profesionale të përcaktuara në paragrafët 1-3 të nenit 17” (neni 16.5), “kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të këtij neni” (neni 17.5), dhe “kushtet e përcaktuara në paragrafët 1-4 të nenit 17” (neni 20.3). Përjashtimin e paragrafëve 2 dhe 3 e nenit 17 e mbështet edhe detyrimi i Qeverisë për të vepruar shpejt.

mbledhur aplikimet e kandidatëve. Madje – për shkak se emërimet duhet t'i paraprijë shkarkimi i një bordi që ka shkelë detyrat dhe rrezikon ta dëmtojë ndërmarrjen – Qeverisë i duhet diskrecion për të identifikuar kandidatët shpejt e pa ndërhyrje nga jashtë.

Përbërja e bordit të përkohshëm

Kandidatët e nominuar në propozim-vendim janë ekspertë të sektorit në të cilin vepron ndërmarrja dhe ekspertë të qeverisjes së ndërmarrjeve, me përvojë të dëshmuar.

Bordi i përkohshëm i drejtorëve do të ketë këtë përbërje:

- znj. Rrezarta Pllana, kryesuese dhe drejtore;
- znj. Merita Kasapolli, drejtore;
- z. Arbnor Pula, drejtor; dhe
- z. Beza Halilaj, drejtor.

Znj. **Rrezarta Pllana** është inxhinierë, menaxhere dhe pedagoge me përvojë të lakmueshme prej dy dekadash. Nga viti 2018, punon si menaxhere projekti dhe analiste biznesi në firmën "Cactus", ku mbikëqyr implementimin e projekteve në Kosovë dhe në Zvicër.

Më parë, ka qenë e angazhuar si eksperte dhe ligjëruese e zhvillimit të databazave në sektorin publik dhe privat, duke përfshirë organizata si byroja e kreditit, Ipko, Trusti pensional, Universiteti i Prizrenit, GIZ-i gjerman, EULEX-i, banka komerciale e të tjerë. Në vitet e hershme të pasluftës, znj. Pllana ka punuar në zhvillimin e databazës së konsumatorëve të energjisë elektrike.

Znj. Pllana ka kryer studimet themelore dhe të masterit në fakultetin teknik të Universitetit të Prishtinës, ku tani është në përfundim e sipër të doktoratës.

Znj. **Merita Kasapolli**, hidroinxhinierë dhe eksperte e mjedisit, ka mbi 20 vjet përvojë me organizata vendore e ndërkombëtare në menaxhimin e ujit, mbeturinave, shërbimeve komunale dhe zhvillimit ekonomik. Ka përgatitur studimet të ndikimit në mjedis për projekte energjetike.

Është diplomuar për hidroinxhinieri në Universitetin e Prishtinës, ku ka marrë edhe gradën master shkencor. Ka punuar si inxhinierë, trajnuese e konsulente për infrastrukturën e shërbimeve komunale me programe të Agjencisë Amerikane të Zhvillimit Ndërkombëtar USAID, Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, Korporatën Financiare Ndërkombëtare IFC, organizatën [IRD] dhe organizata të tjera. Ka mbajtur pozita drejtuese në sektorin e ujërave dhe mbeturinave, duke shërbyer dhe si kryesuese bordi dhe udhëheqëse projektsh për sektorët.

Projekti më i fundit i zonjës Kasapolli ka qenë studimi i parafizibilitetit për projektet e Korporatës së Mijëvjeçarit, që përfshijnë dy nënprojekte të energjisë.

Z. **Arbnor Pula**, jurist dhe [master në administratë] biznesi, ka mbi 20 vjet përvojë menaxheriale e profesionale në shoqëri civile dhe sektorin privat e publik. Përqend-

rohet në çështje të zhvillimit ekonomik, planifikimit strategjik, financave dhe qeverisjes korporative.

Z. Pula ka studiuar në Prishtinë dhe [ka kryer masterin] në Slloveni. Ka shërbyer për një dekadë si drejtor ekzekutiv në Forumin për Iniciativa Demokratike dhe për 3 vjet si drejtor ekzekutiv i Grupit të Zhvillimit Shqiptaro-Kroat. Nga viti 2012 është partner dhe drejtor i zhvillimit të biznesit në ASD Group, një firmë shërbimesh [konsulente] me klientë [vendorë e] ndërkombëtarë.

Ka qenë pjesë e disa grupeve të shoqërisë civile dhe shërbimit publik, duke përfshirë bordet e organizatave Civikos dhe Demokracia në Veprim.

Z. **Beza Halilaj**, kontabilist dhe auditor i certifikuar i sektorit publik, është ligjërues në [Institutin për Kontabilitet Auditim dhe Financa]. Ka përvojë 16-vjeçare si shef auditimi në Bankën Qendrore e në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.

Z. Halilaj është shkolluar në Prishtinë dhe ka ndjekur trajnime të rëndësishme në Evropë e në Amerikë. Ka punuar si mësimdhënës, gazetar, hulumtues, kontabilist e shef prokurimi para se të nisë angazhimin 10-vjeçar me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, ku ka mbajtur pozitat e auditorit, udhëheqësit të ekipit dhe drejtorit të departamentit të auditimit. Nga viti 2014 deri sivej ka qenë shef i auditimit të brendshëm në Bankën Qendrore të Kosovës.

Puna e z. Halilaj në BQK është vlerësuar nga ekspertët e Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Qendrore Evropiane dhe USAID-it.

Bordi me mandat të plotë

Në ndërkohë, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit nis procedurat për përzgjedhjen e drejtorëve me mandat të plotë, sipas ligjit.²¹ Sekretari emëron një komision rekomandues të përbërë nga shërbyes civilë me cilësimet e caktuara në ligj.²² Gjithashtu cakton dhe zbaton rregullat e punës së komisionit, që përfshijnë ndalimin e konfliktit të interesit dhe metodologjinë e vlerësimit.²³ Komisioni pastaj identifikon dhe ia propozon Qeverisë kandidatët për bordin e ri.²⁴ Ecuria e përzgjedhjes së drejtorëve duhet të jetë e hapur dhe e paanshme.²⁵

21 LNP, neni 15, para. 1-2 dhe 5.

22 LNP, neni 15.2.

23 LNP, neni 15.3.

24 LNP, neni 15.2.

25 LNP, neni 15.5.

* * *

Si përfundim, për arsyet e sipërcekura, i propozoj Qeverisë që të miratojë propozim-vendimin për shkarkimin e bordit të tanishëm dhe emërimin e një bordi të përkohshëm të KEK-ut.

Rozeta HAJDARI

Ministre në detyrë

Bashkëngjitje (10):

1. Raport i auditimit të brendshëm, rasti 2018-AO-019, fq. 7, 9
2. Raport i auditimit të pavarur, për vitin 2017, fq. 7, 12
3. Kërkesa e drejtorit të burimeve njerëzore dhe drejtorit të zyrës ligjore drejtuar Bordit të Drejtorëve, pa datë
4. Vendim i Bordit të Drejtorëve të KEK-ut, nr. 4829, 21.6.2019
5. Raporti i vlerësimit të tenderëve, nr. prok. KEK-19-6876-2-1-1
6. Kontratë, nr. prokurimit KEKO-19-322-211, nr. prot. 11629
7. Vendim i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, nr.prot. 01/2599, 18.12.2017
8. Vërejtje e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, nr.prot. 01/2601, 18.12.2017
9. Vendim për miratimin e Deklaratës për Politikën e kompensimit për Zyrtarët e KEK-ut për vitin 2018, 15.3.2019, nr.prot. 3873, 11.6.2019
10. Vendim për Miratimin e Performancës së Zyrtarëve të KEK-ut për vitin 2018, 31.5.2019, nr.prot. 3872, 11.6.2019